

AKT THEMELIMI
I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BAU XHAFER ILAZI SHPK"

Në Lezhë, sot më 05.12.2023 u krijua kjo shoqëri si me poshte:

THEMELUESI:

1. **Z. Xhafer Ilazi** me atësi Emin, amesia Remzie i datelindjes 23.01.1975, lindur ne Torine, Lipjan, Kosove dhe banues ne, 72160 Horb Am Neckar Salzstetter Str 2, Gjermani, shtetas Gjerman, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. 116123 dhe me nr. personal L92PX5HNF.

Themelojme sipas kërkesave te ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare te Biznesit " , si me poshtë:

NENI 1

Te krijoj shoqërinë tregtare me forme ligjore "Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar" me emrin "**BAU XHAFER ILAZI SHPK**" si dhe emertim tregëtar te shoqërisë "**BAU XHAFER ILAZI SHPK**" e cila do te veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotësuar ne te.

NENI 2

Selia e Shoqërisë "**BAU XHAFER ILAZI SHPK**" do te jete ne adresen: Lezhe, Shenkoll, Tale, Gryke lumi, zona kadastrale 1879, pasurine nr. 6/139 dhe do te ushtroje veprimtarinë e saj private për një periudhe kohore te pacaktuar, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 3

Shoqëria do te ketë për objekt te veprimtarisë te saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushën e : Punime ne bujqesi dhe blektori.

NENI 4

Shoqëria mund te ndryshoje emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë se saj, me vendim te ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do te jete: **100,000 (Njeqind mije) leke** e përbërë nga 1 (nje) kuota qe i perkasin ortakut si me poshte.

1. - **Xhafer Ilazi**

me 100 % te kapitalit = 1 kuote = 100,000 leke

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marre ortakut, por në asnjë rast njeri ortak nuk mund të detyroje ortakët e tjerë të rrisin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortakut që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet të njoftojë me pare ortakët e tjerë të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte dhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi të mëtejshme ortakët do të referohen dispozitave të parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008.

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori

Procedura për emërimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

NENI 9

Administrator do jete **Z. Xhafer Ilazi** me atësi Emin, amesia Remzie i datelindjes 23.01.1975, lindur në Torinë, Lipjan, Kosovë dhe banues në, 72160 Horb Am Neckar Salzstetter Str 2, Gjermani, shtetas Gjerman, madhor dhe me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. 116123 dhe me nr. personal L92PX5HNF.

Administratori zgjidhet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme në se janë miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare në lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave në kapitalin themeltar për Asamblesë të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme, kompetencave të ortakeve dhe marrjes së vendimeve do të bazohet në statutin e shoqërisë si dhe në Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shënohet kontributi i ortakut të vetem. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin si

dhe gjithë kërkesave të tjera financiare, të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do të ndahet ndërmjet ortakut të vetëm mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jetë hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

NENI 13

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në katër dokumente origjinale me fuqi të barabartë secila.

ORTAKET E SHOQERISE

1. **Xhafer Ilazi**

